[*Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant per ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në cmim me te ulet*]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;

3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni
---	---	--	--

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk

ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

“Blerje trau automatik”

Sistemi i biletarise dhe parkimit

Sistemi do të përbëhet nga:

- *Pajisjet qendrore të sistemit – Parking inteligjent profesional, softëare i administrimit të sistemit, ruajtjes së administrimit të imazheve e kalimeve, traret, kabinen, programin e monitorimit te biletave.*
- *Kamera profesionale të sigurisë.*
- *Pajisjet ndihmëse funksionuese*
- *Projekti duhet të dorëzohet I përfunduar me të gjitha punimet infrastrukturore të mundshme e shoqëruar me deklaratë garancie teknike .*
- *Operatori ekonomik duhet të siguroj të gjitha paisjet si dhe të realizoj montimin e tyre ,duke kryer edhe punimet e duhura infrastrukturore , të gjitha punimet e kryera në fund të zbatimit të detajohen dhe të hidhen në një plan të detajuar si dhe realcion teknik punimesh.*
- *Operatori ekonomik duhet të bejë furnizimin dhe montimin e të gjitha pajisjeve.*
- *Operatori ekonomik duhet te mbuloj furnizimin fillestar me te pakten 3000 bileta pa kosto shtes.*
- *Pas përfundimit të instalimit operatori ekonomik duhet të ofroj trajnim për përdorimin e stafit të institucionit*

1. *Pajisjet qendrore te sistemit – Parking inteligjent profesional, softëare i administrimit të sistemit, ruajtjes së administrimit të imazheve*

Pajisja qendrore e regjistrimit dhe administrimit të imazheve e kalimeve dhe vetë sistemit, do të jetë një pajisje “e gjitha në një” e cila përmban:

- *Softëarin e nevojshëm për administrim të imazheve*
- *Softëarin e nevojshëm për administrimin e vetë sistemit te biletarise*
- *Hardëarin e nevojshëm për rregjistrimin e imazheve dhe administrimit te kalimeve.*

Sistemi i biletarise së menaxhimit të automjeteve

- *Parkimi do te pajiset me Sistem te Menaxhimit te Automjeteve te kontrolluar.*
- *Te gjithe pajisjet do te jene me konstruksion te forte, rezistente ndaj vandalizmave dhe rezistente ndaj motit.*
- *Barrierat hyrese do te jene te mbushura me sinjale automatike ndriçuese.*
- *Fotocelulat IR te sigurise do te jene te mbushura ne te gjitha barrierat.*

-
- *Sistemi i kontrollit qendror do te jepet grafikisht dhe do te siguroje nje raport ne kohe reale per te gjithë statusin e sistemit.*
 - *Sistemi do te pranoje nje sinjal ne raste zjarri qe do te mbylli te gjitha hyrjet dhe te hape te gjitha daljet.*

Konfigurimi i Sistemit Per menaxhimin e parkimit do behet e mundur nga Sistemi i Menaxhimit te Automjeteve. SMA do te perbehet nga barrierat e makinave automatike dhe lexuesit e kartes qe do te jene te pozicionuar ne hyrje dhe ne dalje. Lexuesit e kartes do te jene pjese e kontrollit te sistemit te hyrjes. Përveç lexuesit te kartes ne hyrje do te jete e mundur qe barrierat te kete nje hapje manuale nga dhoma e sigurise. Fotocelulat IR te sigurise do te jene te mundura ne te gjitha barrierat. Te gjithë kontrollet e barrieres do te jene te lidhura me njera-tjetren ne linj me RS-485 ose me tip te ngjashem dhe perfundojne ne dhomen e sigurise ku do te jene te monitoruara ne kohe reale per gjendjen e tyre. Monitorimi dhe kontrolli do te behet nepermjet softëare-it. Nderfaqja eshte e domosdoshme ndermjet RS-485 ose tipeve te ngjashme qe vjen nga PC ne vendin qe do jete instaluar softëare-i. Ne rast te alarmit te zjarrit do te tejcohet nje sinjal direct te barrierat per te mbyllur hyrjen dhe hapur daljen. Pas rivendosjes se sinjalit sistemi do te kthehet ne pozicionin e saj te meparshem ne drejtim e te gjitha variablave. Parkimi do te operoje ne dy menyra: me karte kontrolli hyrje ose bilete. Biletat do te mundesohen ne hyrje dhe do te paguhen ne Qendren e Kontrollit (gabina e kontrollit). Pas pageses se biletës do te operohet ne dalje per hapjen e barrierave.

Ne parkim do te instalohen pajisjet e meposhtme:

Ne hyrje

- ✓ *Njesia hyrese*
- ✓ *Barriere automatike*
- ✓ *Loop-e te sigurise ose/dhe fotocelule IR*
- ✓ *Lexues karte*

Ne dalje

- ✓ *Njesi dalese*
- ✓ *Barriere automatike*
- ✓ *Loop-e te sigurise ose/dhe fotocelule IR*
- ✓ *Lexues karte*

Njesite Hyrese/Dalese

Njesia hyrese do te instalohet ne hyrjen e parkimit. Ajo(paisja) i jep nje bilete personit per te fituar akses ne parking. Kjo paisje eshte projektuar per te menaxhuar hyrjen me bileta me barcode, ne trupin e saj kjo ka nje buton per te kerkuar biletën dhe nje lexues per kartat transponder s i dhe nje buton help.

- *Shtyp Butonin PUSH ne Qendren e re te Hyrjes , Bileta me Bar-code do te terhiqet nga klienti dhe traun do te hapet.*
- *Mbasi makina do te kaloje sistemi automatikisht do te mbyllë traun dhe te numeroje makinën.*

- Cdo hapje e traut dhe cdo numerim i makines do te kryeje nje foto nepermjet IP-Kamera , te emertuar dhe me numrin qe ndodhet ne biletën me Bar-Code dhe te rregjistrohet
- Ne qofte se makina nuk eshte prezent dhe trau do te hapet Manualisht , fotografia do te ruhet me emrin “ hapje manuale nn “ , data dhe ora do te jene te shenuara gjithashtu ne foto.
- Ne qofte se ndodh ndonje problem ne hyrje , klienti mund te shtype butonin HELP dhe te flase me operatorin.
- Aktivizimi i funksioni “Anti-pass back “ qe te evitohet mashtrimet nga klientet me parapagim dhe klientat VIP.

Njesia dalese do te instalohet ne daljet e parkimit. Me te perdoruesi mund te dale pas pageses ne kase. Personat e autorizuar mund te perdorin kartat e tyre duke kaluar karten afer sensorit/lexuesit. Njesia dalese lejon perdorimin e kartave qe kane kryer pagesen per te menaxhuar barrieren dalese.

1. Te HAPE traun , te numeroje makinen dhe te ruaje ne database si foto No .
2. Te llogarise kohen e qendrimit dhe vleren, dhe automatikisht ta kaloje ne grafikun e kalimeve.
3. HAPJA e traut behet e mundur edhe manualisht nga qendra e kontrollit gjithashtu (ky sherbim mundesohet per rastet e panikut) , dhe ne kete rast gjithashtu shkrepet nje fotografi e cila memorizohet dhe makina numerohet ne qofte se kalon

Monitorimi, Raportet dhe kontrolli do te behet nepermjet softëare-it ne Gjuhen Shqipe.

Softëare i Sistemit te Parkingut Mundeson :

1. Raporte te personalizuar per cdo Operator.
2. Raporte te pergjithshme (Javore, Mujore, Vjetore)
3. Raporte Ditore
4. Raporte te Hyrje Daljeve
5. Raport per Klientet VIP ose te autorizuar.
6. Monitorim On-Line ne Distance, dhe marrja dhe hedhja e te dhenave nga distanca
7. Raporte mbi Hyrje dalje Manuale, Arka, Shitjet... etj

Si realizohet kontrolli i perdoruesëve

Sistemi duhet t'i ofrojë administratorit :

- Mundësinë e krijimit të perdoruesve të ndryshëm, me të drejta të ndryshme aksesi.
- Kontrollin e perdoruesve që kanë të drejta aksesi, ose jo, në sistem.
- Aftësinë për të gjeneruar një listë me perdoruesit që janë online në sistem.


Që ky sistem të funksionoj duhet detyrimisht të ketë edhe gabinën e operatorit e cila ndryshe do të quhet qendra e kontrollit të parkingut .

Stacioni qendror i kontrollit konsiston ne ndertimin e Kabines se Operatoreve te monitorimit te Sistemit te Menaxhimit te Automjeteve dhe te Sistemit CCTV. Stacioni qendror i kontrollit ,do te ndertohe me strukture Profile Hekuri ose Alumini,Veshje me panel termoizolues,xhama te temperuar rezistente ndaj kushteve atmosferike. Qendra e Kontrollit te Parkingut duhet te dorezohet me sistemin e ndricimit elektrik ,rrjetin e internetit dhe Menaxhimit te Automjeteve. Ne Stacioni qendror i kontrollit do te instalohet edhe nje kompjuter dhe nje monitor minimumi 21” per te monitoruar te gjithe vendet dhe per te kontrolluar pamjet e regjistruara nga Sistemi CCTV. Programi i monitorimit duhet te lejoje klientet te monitorojne disa vende nga nje perdorues i vetem.

Te jete i perfshire dhe ëorkstationi per funksionimin normal te sistemit

Permasat e Qendres se Kontrollit te Parkingut sygjerohen te jene brenda parametrave te meposhtem me qellim konformitetin e perdoruesit si dhe te mar paisjet e nevojshme qe do instalohen brenda gabines.

Gjeresia min 1300 - 1500 x Gjatesia min 1600 - 1900 x Lartesia min 2000- 2300.







Foto illustruere



Sistemi CCTV perbehet nga kamera fikse te insaluara tek hyrjet/daljet e parkimit sygjerohet edhe montimi i dy kamerave në dy anët e parkimit per te monitoruar pjesen e levizjes se makinave per te siguruar cilesi te larte mbikqyrjeje. Parkimi do te kete grupin te kamerave dhe pajisjeve CCTV te vendosura ne Qendra e Kontrollit te Parkingut.. Te gjitha kamerat do te lidhen me kabell. Qellimi I Sistemit te monitorimit me Kamera eshte monitorimi I trafikut dhe I hyrje daljeve te Parkingut.

Sistemi permban:

- Kamera, fikse, me ngjyra 4 copë*
- Ushqyes per lidhjen e kamerave dhe furnizimin e tyre*
- NVR per manaxhimin dhe regjistrimin e videove.*

Kamerat fikse do te jene me ngjyra dhe te pajisura me te gjitha aksesoret fiksues dhe mbrojtës.

o Kamera IP

o Performance e avancuar ne drite te ulet

o Resolucion minimal 3 Megapixel (MPx)

o Deri ne 30 Imazhe per sekonde (fps) ne 2 MPx

o Lente Varifocal 2.8 ~ 12 mm MPx me Auto Back Focus

Pajisjet e regjistrimit do te jene me cilesi regjistrimi me minimumi 4 kamera ne nje minimum prej 31 ditesh ruajtje te regjistrimit. Keto regjistruesit do te jene plotesisht te programueshem per funksione kohe,dhe te monitorohen online nga distanca.

Sistemi i It dhe funksionimi i tyre

Barriera me elektromotor, gjatësia e krahëve sipas përmasave të vendit të instalimit/infrastrukturës.

Specifikimet Barriera Automatike me BILETARI.

Barrierat Automatike Krahet e barriers automatike do te instalohen ne hyrje dhe dalje te parkimit.

Krahet e barriers do te fiksohen ne mekanizmin shear-off bolts/plate.

Barriera do te kete lehtesi per perdorim manual nepermejt nje celsi. Pjesa operative e barrierave do te komunikojë me qendren e kontrollit duke monitoruar statusin e barrierave.

Barrierat do te jene totalisht rezistente ndaj motit dhe do te pajiset me nje ngrohje anti kondensimi.

Barrierat duhet te jene te pershtatshme per instalimin dhe funksionimin ne te gjithë kushtet e motit.

Barrierat te kene te instaluar ne Trup sinjalizimin me drite te gjelber per lejimin e kalimit te automjeteve kur barriera hapet dhe me drite te kuqe ndalimin e kalimit per automjetet kur barrier eshte e mbylluar.

Barrierat te kene ne Control board funksionet Open-Close-Block kontakte te ndara.

Barrierat te komandoje semafor te jashtem per sistemin.

Barrierat te kene detyrimisht funksionin BBF (Bounce Back Function)

Çdo barrier do te kete fotocelulat IR sigurie qe te parandalojë mbylljen e barrieres mbi makine.

Aksesimi ne te gjithë kabllot lidhese do te jete e mundur pa qene e nevojshme per cmontim te plote.

Ne hyrje dhe dalje do te intalohet fotocelulat IR dedektimi. Fotocelulat IR do te jete instaluar direkt ne barrier per te dalluar prezencen e automjeteve dhe per te parandaluar mbylljen aksidentale mbi automjete. Fotocelulat IR do te perdoren per operimin automatik te barrierave ne hyrje dhe dalje.

Transmetimi infra të kuqe me anë të modulimit digjital të sinjalit të bartësit. Marrja me demodulim dhe dekodim i protokollit, për njohjen e pajisjes transmetuese.

Te mundesoje që të lidhen deri në 3 pajisje Cascading, duke multipleksuar transmetimin pa ndërhyrje; zgjedhja të bëhet me anë të një dip-sëitch dyanshëm vend si në TX dhe RX lidh tre transmetuesit me njëri-tjetrin Mundësia e zgjedhjes së prodhimit me kontakt të pastër ose 8.2 K Ω , sinjalizuar diferencuar LED në marrës: gjendja e "funksionimit të duhur", sinjalizuar nga një aktivizim të shkurtër të përhershme (çdo minutë), gjendja e "alarmit" sinjalizuar nga LED gjithmonë në.

Optika e marrësit para amplifikuar.

Furnizim i përforcuar i energjisë për të toleruar tensionet deri në 40 Vdc ose 28 Vac.

Dimensionet 50 x 90 x 40.

Kamera Per leximin e targave

Të bëjë leximin automatik të makinave targave dhe ti afishojë në programin e monitorimit.

- *Arkë manuale*

Sistemi i menaxhimit ka ne perbërje edhe disa pajisje te nevojshme per menaxhimin, leshimin dhe njohjen e biletave. Ne to perfshihen:

- *Sirtar me ndarje për mbajtjen e monedhave dhe kartëmonedhave*
- *Skaner barkode statik per leximin e biletave me specifikimet e meposhtme:*

Karakteristika teknike minimale	
<i>Teknologjia</i>	<i>Lexuesh Barkodesh</i>
<i>Mundesitë e dekodimit të barkodeve</i>	<i>Standart 1D</i>
<i>Kendi i skanimit</i>	<i>Horizontal: 50° ose më mirë</i>
<i>Karikimi/Teknologjia e energjisë</i>	<i>Pa bateri</i>
<i>Lidhja</i>	<i>Me kabell</i>
<i>Ndërfaqet e sistemit pritës</i>	<i>USB, RS-232, Keyboard Edge, RS-485</i>
<i>Modeli i skanimit</i>	<i>Nje linje skanimi</i>
<i>Rënia</i>	<i>Deri ne 1.5 m (5') rënie</i>
<i>Lagështia</i>	<i>5% deri në 95%</i>
<i>Temperatura e operimit</i>	<i>0°C deri në 40°C</i>
<i>Mbyllja mjedisore</i>	<i>E paspecifikuar</i>
<i>Shpejtesia e skanimit</i>	<i>70 + Linja skanimi / Sekondë</i>
<i>Garancia</i>	<i>Minimumi 3 vite nga prodhuesi</i>

Server lokal

Serveri do të shërbejë për transmetim të dhenash midis serverit dhe stacionit hyrje dhe dalje dhe regjistrimin e kartave të aksesit si për sistemin e mjeteve motorike me specifikimet teknike të mëposhtme.

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
<i>Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net</i> <i>Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:</i>	<i>12000 Pikë</i>
<i>“RAM”:</i>	<i>16 GB, min. DDR4 2666 MHz, ECC</i>
<i>Madhësia e Hard Diskut “HDD Size”:</i>	<i>(1) x 256 GB SSD Sistemi Operativ dhe (3) x 1000 GB HDD</i>
<i>Shpejtësia e Hard Diskut “HDD Speed”:</i>	<i>7200 RPM SATA 6.0 Gb/s për HDD</i>
<i>“Disk Subsystem Controller”:</i>	<i>Serial ATA III 6.0 Gb/s, Minimum 4 Serial ATA Interface ëith RAID 0,1,5,10 Support. (Hard Disk të Konfiguruar në RAID 1).</i>
<i>Karta Grafike “Graphics”:</i>	<i>Kartë Grafike HD e Integruar up to 2GB</i>
<i>“Media Device”:</i>	<i>DVD+/-Rëëith Dual Layer DVD+R ëri. Capacity</i>
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
<i>Portat e Komunikimit “Ports”:</i>	<i>Min. (6) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (2) USB 3.0 (2) RJ-45, (1) Portë Video (mund të përdoret dhe adaptor)</i>
<i>Rrjeti “Networking”:</i>	<i>(2) 10/100/1000 LAN Gigabit Ethernet Port</i>
<i>Siguria “Security Management”:</i>	<i>Embedded Security TPM 2.0</i>
<i>Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O. S.”:</i>	<i>OEM Eëindoëës Server 2016 Standard 64-bit</i>
<i>Tastiera “Keyboard”:</i>	<i>Standart Keyboard QëëERTY</i>
<i>“Mouse”:</i>	<i>Minimum 3 Button scroll Optical</i>
<i>Ushqimi “Poëer Supply”:</i>	<i>220 V AC, 50 Hz</i>
<i>Kursimi i energjisë “Energy Efficiency”:</i>	<i>Energy Star</i>
AKSESORËT	
<i>Kabëll “Poëer Cord”:</i>	<i>Po, European</i>

MONITORI	
Tipi "Type":	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
Madhësia "Size":	≥21"
Rezolucioni "Native Resolution":	1920 x 1080 @ 60 Hz
Raporti i Kontrastit "Constrast Ratio Static":	1000:1
Koha e Rifreskimit "Response Time":	≤ 6 ms
"Display Port":	(1) VGA/DVI ose DP/DVI/HDMI
Kursimi i energjisë "Energy Efficiency":	Energy Star
Ushqimi "Poëer Supply":	220 V AC, 50 Hz

Infrastruktura

Ne kete projekt kerkohet te kryhen instalime dhe terminimi i fibres optike dhe furnizimit me energji elektrike nga Dhoma teknike deri tek Gabina Operatorit te biletave ne distance mbi 300 m në vij ajrore .

Te gjitha lidhjet elektrike qe do te behen ne kutite shperndarese do te behen me klema elektrike. Nese do te kete me shume se dy kuti shperndarëse do të lidhet gjithmonë një deri në dy tuba rezervë për komunikimin midis tyre. Kutitë shperndarëse duhet të zgjidhen në madhësinë e duhur pa krijuar ngjeshje dhe ngatërrim të fijeve që bashkohen. Pozicionimi i tyre duhet të bëhet në pozicione sa me pak të dukshme për syrin duke respektuar kushtet dhe normat elektrike që duhen për të punuar dhe operuar në rast shërbimi. Duhet të ruhet rregulli i shtrirjes së tubave duke mos i dhënë kënde të forta.

Fibra optike duhet te kete keto karrakteristika:

Outer sheath PE (optional LSZH sheath)

Octine steel tape

(a) Glass fiber

(a) Eater resistant Tube Filler Gel


Diameter 1.70 ±0.2mm

Fibër Optike Multi Mode do te terminohet me konektorë LC në të dyja anët dhe do te lidhet me rrjetin me ane te 2 (dy)pajisjeve Media konverter me specifikimet e meposhtme:

Modeli	Multimode fiber Media Converter
Porta	<i>1x10/100/1000Base -T Rj45 1x1000 Base -x SFP te perfshire LC Duplex MM</i>
Model Fibre	<i>Multimode 50/125µm, 62.5/125µm</i>
Sinjalizues Led	<i>FX/SPD, FX/LINK, PËR, LINK/ACT, SPD</i>
Standart Protokoll	<i>IEEE802.3u, IEEE802.3z, IEEE802.3ab, 1000Base-TX/FX</i>
Input Poëer	<i>DC 9-56V, 0.5/0.25A</i>
MTBF (hrs)	<i>>100,000Hrs</i>
Garancia	<i>1 vit</i>

Inverter +Bateri

Modeli	<i>Inverter dhe charger: 1(një) fazor ne hyrje dhe 1(një) fazor në dalje</i>
Fuqia	<i>≥ 1000VA / 1000 ËAT</i>
Tensioni nominal në hyrje	<i>220 / 230 / 240VAC, 50Hz;</i>
Diapazoni i tensionit në hyrje	<i>175 – 265 VAC;</i>

Tensioni i charger-it	12 VDC (nominal);
Rryma e charger-it	≥ 50 Amper;
Tensioni ne dalje	Pure Sineëave, 220/230/240VAC
Frekuenca ne dalje	50HZ (battery mode)
Koha e transferimit	≤ 10 ms;
BATERITË	
Bateri	<p>Hermetike, pa mirëmbajtje, AGM, VRLA, stand-by battery... e rekomanduar <u>për aplikime për invertera dhe UPS</u> (Jo bateri per makina); 12V – 100AH; 1copë për inverter, të përfshira;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Baterite duhet te shoqerohen me: ISO 9001 - 2008, CE dhe RoHS declaration. • Baterite duhet te jene me terminale F12: <p>Terminal F12</p> 
LED display	Për treguesit e hyrje daljes dhe alarmeve përkatëse
Mbrojtjet	Discharge, Overcharge, Overload
Kabllo e lidhjes se baterisë dhe aksesorët	Të përfshira
Garancia	jo me pak 12 (dymbëdhjete) muaj

<i>Instalimi</i>	<i>I përfshire: instalimi i pajisjes, baterive dhe aksesoreve përkatës</i>
-------------------------	--

Kjo procedurë është furnizim-vendosje dhe mallrat e furnizuara do të montohen nga operatori ekonomik fitues.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

“BLERJE TRAU AUTOMATIK”

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi mesatar/njësi pa TVSH	Vlera pa TVSH
1	Kolona e tërheqjes automatike së biletave hyrëse me vetëshërbim	copë	1		
2	Kolona dalëse automatike me vetëshërbim	copë	1		
3	Sistem Softëare i Menaxhimit	copë	1		
4	Barriera elektronike me ndriçim (trau)	copë	2		
5	Gabine Operatori ku përfshihen dhe punimet për infrastrukturen ndërtimore, elektrike dhe rrjet interneti	copë	1		
6	Arkë manuale	copë	1		
7	Server Lokal	copë	1		
8	Inverteri 230VAC 1250 ëat	copë	1		
9	Baterite 12 V 100 AH, bateri të thata, hermetikisht të mbyllura	copë	1		
10	Scaner Barcodi	copë	1		
11	Media converter 10/100/1000Mbps	copë	2		
12	Sistem kamerash (4 copë +Rregjistrues)	copë	1		
Totali					
TVSH					
Totali me TVSH					

Afatet e lëvrimit: Brenda 1 (një) muaji nga data e lidhjes së kontratës.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kriteri 2.2.1 Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e ulët se 1 160 000 lekë (pra kjo vlerë e xhiros minimale vjetore nuk tejkalon 40% të vlerës së parashikuar të kësaj kontrate).

2.3 Kapaciteti teknik:

Kriteri 2.3.1 Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të ulët se 580 000 lekë. (pra kjo vlerë totale e kontratave të mëparshme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nuk është më e madhe se 20% e vlerës së përllogaritur të kësaj kontrate).

-
- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku e shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe faktura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fakturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Kriteri 2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë, Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për produktet e sistemit të parkimit dhe pajisjet ndihmëse (Server, Media converter, Inverter). Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, uebfaqe, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Kriteri 2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatën për sistemin e menxhimit të cilësisë ISO 9001 (e vlefshme) ose ekuivalente. Certifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kriteri 2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalogë ose broshura për mallrat që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e ofruar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. (Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që Autoriteti Kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të ofertuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmërinë e tyre).

Kriteri 2.3.5 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar të paktën 3 (tre) punonjës të nevojshëm për objektin e prokurimit, ndër të cilët punonjësit duhet të jenë:

- (një) inxhinier elektronik/informatike ose specialist të teknologjisë së Informacionit i certifikuar
- 2 (dy) punonjës teknik / specialist në përputhje me objektin e prokurimit.

Për punonjësit e punësuar, me arsim të lartë të paraqiten:

- Kontratë pune;
- Diploma e studimeve universitare;
- Vërtetim të sigurimeve shoqërore për periudhën e të paktën 3 muajve të fundit nga data e zhvillimit të kësaj procedure prokurimi.

Për punonjësit e punësuar, me arsim të mesëm të paraqiten:

- Kontratë pune;
- dëshmi/certifikata kualifikimi profesionale përkatëse, të lëshuar nga institucione të licensuara nga Republika e Shqipërisë ose ekuivalent.
- Vërtetim të sigurimeve shoqërore për periudhën e të paktën 3 muajve të fundit nga data e zhvillimit të kësaj procedure prokurimi.

Ky kriter permbushet me plotësimin e formularit të vetdeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari do të duhet të dorëzojë dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, I ndryshuar si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Shenim për operatorët ekonomik:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”

Gjithashtu risjellim ne vemendje se:

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit permbushes per keto pika do te jete kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht skualifikimi.
- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
---------------------	------------------

Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

